



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1784/9 prot.

Pogradec, më 23, 04, 2026

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


E nderuar Zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dokumentacionim justifikues dhe relacionin shoqërues, për:

1. “Për disa shtesa dhe ndryshime mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit taksi në Bashkia Pogradec”.

Me respekt,

KRYETARI
Hir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy).

Nr. i faqevit A4 të relacionit shoqërues: 3 (Tre)

Vendim i Asamblese së Përgjithshme: 1 (Një).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI



Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ .2026

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2026

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE
FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKIA POGRADEC**

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; pikën 6 të nenit 23, shkronjat "k" dhe "n" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetore dhe enteve publike"; nenin 35 të Ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar; neni 85 i Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe në zbatim të Kreu III të Udhëzimit Nr. 1649, datë 16/08/1999, "Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar, me propozim të shoqërisë Pogradeci Invest Shpk dhe Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratohen disa shtesa dhe ndryshime mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit taksi në Bashkia Pogradec, mbi zhvendosjen dhe krijimin e disa zonave të reja, të rezervuara për shërbimin taksi, të pasqyruara si më poshtë:
 - 1.1 3 (tre) vendeve të rezervuara (Parkim) për shërbim taksi, të ndodhura pranë Hotel Rich të zhvendosen përballë me Kishën e Re, sipas hartës bashkëngjitur.
 - 1.2 Vendosja e 2 (Dy) vende parkimi për shërbim taksi pranë Rrotullimit në Rruga Industriale, Lagja Nr. 1, sipas hartës bashkëngjitur.
 - 1.3 Vendosja e 2 (Dy) vende parkimi për shërbim taksi në afërsi të afërsi të tregtarëve të fruta perimeve në Lagja nr. 1, Rruga Industriale.

2. Efektet: **Disiplinimi i shërbimit taksi në interes të përgjithshëm të komunitetit.**
3. Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec, dhe Administrata e Shoqërisë, Pogradeci Invest Shpk.
4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
5. U shpall sot më datë __. __. 2026.



**KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI**



POGRADECI INVEST Sh.p.k
ADMINISTRATORI



Pogradec, më 23.07.2026

Nr. 1784/9 Prot.

RELACION
PËR
PROJEKT- VENDIMIN ME OBJEKT,

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT
DHE FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKIA
POGRADEC

E NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Administrata e shoqërisë Pogradeci Invest Shpk, dhe administratori në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe në zbatim të statutit të shoqërisë, bazuar në kërkesat e drejtuesve të vetë mjeteve, por edhe për të qëndruar më pranë nevojave të komunitetit, fillimisht kanë propozuar pranë Asamblesë së Përgjithshme disa kërkesa për shqyrtim dhe miratim paraprak, sim ë poshtë:

- 3 (tre) vendeve të rezervuara (Parkim) për shërbim taksi, të ndodhura pranë Hotel Rich të zhvendosen përballë me Kishën e Re.
- Vendosja e 2 (Dy) vende parkimi për shërbim taksi pranë Rrotullimit në Rruga Industriale, Lagja Nr. 1.
- Vendosja e 2 (Dy) vende parkimi për shërbim taksi në afërsi të afërsi të tregtarëve të fruta perimeve në Lagja nr. 1, Rruga Industriale.

Propozimet e shoqërisë, u shqyrtuan nga Asambleja e Përgjithshme, sipas pikes “Të tjera”, të rendit të ditës, dhe Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme është miratim në parim dhe **shërben vetëm për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë** (Referuar dispozitat të Ligjit nr. 9901) dhe i shtrin efektet e veta juridike, pasi të **miratohet edhe nga Këshilli i Bashkisë Pogradec, në respektim të nenit 35 të Ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.**



Për sa më sipër relatojmë se:

Shërbimi taksi është shërbim publik i licencuar, që siguron transport të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë të udhëtarëve dhe bagazheve, që kryhet vetëm me mjete të prodhuara për transport udhëtarësh.

Shërbimi Taksi me autoveturë me drejtues mjete ose shkurt shërbimi taksi, sipas Ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar, rregullohet nga aktet në zbatim që veprojnë në këtë sektor transporti.

Transporti i udhëtarëve me taksi, rregullohet edhe me Ligjin Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, sipas të cilit; Këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet (neni 35).

Gjithashtu, Kreu III i Udhëzimit të MTI Nr. 1649, Datë 16/08/1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, I ndryshuar, sanksionon se:

1. Shërbimi taksi është transport rrugor publik që siguron transport të menjëhershëm të udhëtarëve dhe bagazheve të tyre deri në destinacion, duke zgjedhur itinerarin më të shkurtër, me mjete sipas nenit 3, pika 3.16 të ligjit.

2. Vendet e qëndrimit dhe nisjes së taksive përcaktohen me vendim të Këshillit të Bashkisë ose të Komunës dhe organeve të tjera kompetente si ato të aeroporteve, hekurudhave, porteve dhe agjencive të transportit urban dhe ndërkombëtar Brenda juridiksionit të tyre.

Automjetet taksi në këto terminale zënë vend sipas radhës së ardhjes së tyre. Vendet e caktuara nga bashkitë ose komunat janë të destinuara si vend nisjeje vetëm për taksitë në juridiksionin e këtyre bashkive ose komunës dhe të licencuara sit ë tilla.

Nuk lejohet qëndrimi i një autoveture në shërbimin taksi, e licencuar në një njësi të qeverisjes vendore, në vendin e qëndrimit të autoveturave në shërbimin taksi të një njësie tjetër të qeverisjes vendore. Taksitë e bashkive ose komunave tjera mund të lenë udhëtarë në këto vendqëndrime, por nuk mund të marrin udhëtarë prej andej.

3. Këshilli Bashkiak ose komunës përveç dispozitave të ligjit dhe këtij udhëzimi mund të përcaktoj me vendim të tij rregulla të tjera specifike me synim përmirësimin e këtij shërbimi, rregulla që kanë fuqinë vetëm brenda juridiksionit përkatës.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë disiplinimin e shërbimit taksi, si masë e domosdoshme për përmirësimin e rendit urban dhe rritjen e cilësisë së jetesës në territorin e bashkisë.

Për sa më sipër mendojmë se projektvendimi i ri bashkëngjitur është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore.



Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Ju Faleminderit,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptoi: Aurel Guri

Pranoi: Manuela Jaiçari

Miratoi: ADMINISTRATOR Kledi ÇELA

Konfirmoi: KRYETAR

ILIR XHAKOLLI



POGRADECI INVEST Sh.p.k
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 82 Prot.

Pogradec, më 23.04 2026

VENDIM

NR. 7, DATË 23.04.2026

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT
DHE FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKIA
POGRADEC**

Sot më datë 23.04.2026, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë Pogradeci Invest SHPK, e perfaqesuar nga z. Ilir XHAKOLLI, në cilësinë Kryetarit të Bashkisë Pogradec, me 100 % të aksioneve, referuar diskutimeve dhe propozimeve të relatuara nga Këshilli i Bashkisë Pogradec në mbledhjen e dates 25.02.2026, si dhe pasi u njoh me zbardhjen e procesverbalit të kësaj mbledhje, u mblodh në ambjentet e Bashkisë Pogradec, për të zhvilluar mbledhjen e vet me rend dite, si më poshtë vijon:

- 1. Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqërisë POGRADECI INVEST SHPK, për vitin 2026.*
- 2. Për rishqyrtimin e tarifave të administrimit për ndërtesat që do të administrohen nga shoqëria POGRADECI INVEST SHPK.*
- 3. Të tjera.*

Duke qënë se ne mbledhje eshte prezent personalisht ortaku i vetem i shoqerise, perkatesisht: z. Ilir XHAKOLLI, shtetas Shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, pasi kaluam në pika 3 e rendit të ditës, “Të tjera”, u njoh me kerkesat e parashtruara nga z. Kledi ÇELA, ku kërkoi disa ndryshime mbi mënyrën e organzimit dhe funksionimit të zonave të rezervuara (Parkimet) e shërbimit taksi, në qytetin e Pogradecit.

KONSTATOHET SE:

Shërbimi taksi është shërbim publik i licencuar, që siguron transport të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë të udhëtarëve dhe bagazheve, që kryhet vetëm me mjete origjinale të prodhuara për transport udhëtarësh.

Shërbimi Taksi me autoveturë me drejtues mjete ose shkurt shërbimi taksi, sipas Ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" rregullohet nga aktet në zbatim që veprojnë në këtë sektor transporti.

Transporti i udhëtarëve me taksi, rregullohet edhe me Ligjin Nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", sipas të cilit; **Këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet (neni 35).**

Për sa më sipër, si dhe pasi u ballafaqova me; shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 81 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; nenin 35 të Ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, *me qëllim përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,*

VENDOSA:

1. Të miratoj në parim disa ndryshime në zhvendosjen e disa zonave të rezervuara për shërbimin taksi në qytetin e Pogradecit, të pasqyruara si më poshtë:
 - 1.1 3 (tre) vendeve të rezervuara (Parkim) për shërbim taksi, të ndodhura pranë Hotel Rich të zhvendosen përballë me Kishën e Re, sipas hartës bashkëngjitur.
 - 1.2 Vendorsja e 2 (Dy) vende parkimi për shërbim taksi pranë Rrotullimit në Rruga Industriale, Lagja Nr. 1, sipas hartës bashkëngjitur.
 - 1.3 Vendorsja e 2 (Dy) vende parkimi për shërbim taksi në afërsi të afërsi të tregtarëve të fruta perimeve në Lagja nr. 1, Rruga Industriale.
2. Ky vendim shërben vetëm për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe i shtrin efektet e veta juridike pasi të miratohet edhe nga Këshilli i Bashkisë Pogradec, në respektim të nenit 35 të Ligjit Nr.8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar.
3. Ngarkohet administrator, administrate e bashkisë dhe administrata e shoqërisë për ndjekjen e procedurës ligjore për dorëzimin e çdo dokumentacioni të nevojshëm për në Këshillin e Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË POGRADEÇ
(NË CILËSINË E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË POGRADECI

INVEST SHPK)
ILIR XHAKOLLI



PLANVENDOSJE E SUBJEKTIT

ZK 8581 POGRADEC

KONCEPTI:
INXHINIER I D.P.K.ZH.T
ARSEL LIÇKOLLARI


OBJEKTI:

VENDPARKIM TAXI
(3 VENDE)

PËRMASAT:
SIPËRFAQE TOTALE E
SHFRYTEZUAR
 $3 \times 13.75 \text{ m}^2 = 41.25 \text{ m}^2$

POROSITËSI:
TAXI

VEND PARKIM
TAXI (3 VENDE)



VENDODHJA E SUBJEKTIT

RRUGA E KORCES

357

PLANVENDOSJE E SUBJEKTIT

ZK 8581 POGRADEC

KONCEPTOI:
INXHINIER I D.P.K.ZH.T
ARSEL LIÇKOLLARI

OBJEKTI:

VENDPARKIM TAXI
(2 VENDE)

PËRMASAT:
SIPËRFAQE TOTALE E
SHFRYTEZUAR
 $2 \times 13.75 \text{ m}^2 = 27.5 \text{ m}^2$

POROSITËSI:
TAXI

